

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklarata - Kërkesa e këshilltarëve të PS për SPAK/ Teliti: Mbledhja s
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919260/kerkesa-e-keshilltareve-te-ps-per-spak-teliti-mbledhja-s-eshte-leje-per-te-marre-ajer-veliaj-po-mban-peng-bashkine/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 07:02:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:56:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dcd4c52462400add162d00ef344f58d5ce9d5eafb0da44dcbb8e4d627b9c5
TEKSTI	2dae46f9bae1ed1d9e71416c868acdca159b0c12a2f8e1a953eec27e8db04775
PAMJA	984e4de3a6380e6a7dfed6ed5632198efa0bcd6b060668dd83e00e4960922261

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7acd795717d326f1ada77a43ac9d48fd9e3c06401a31617039ff93c7e428ec5a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7acd795717d326f1ada77a43ac9d48fd9e3c06401a31617039ff93c7e428ec5a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtareve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!



Kërkesa e këshilltarëve të PS për SPAK/ Teliti: Mbledhja s'është leje për të marrë ajër Veliq. Po mban peng bashkinë

08:56, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nënkryetari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, Dorian Teliti, ka deklaruar se kërkesa e drejtuar SPAK-ut për të sjellë Erion Veliqin nga paraburgimi në mbledhjen e javës së ardhshme nuk është një vendim i përbashkët i Këshillit, por dëshirë ekskluzive e mazhorancës socialiste.

Në një intervistë për MCN TV, Teliti sqaroi se kryesia e Këshillit nuk është mbledhur dhe as nuk ka diskutuar për një kërkesë të tillë, duke akuzuar të majtët se po përpiqen ta shesin politikisht sikur është një vullnet i të gjithë këshilltarëve.

'Jemi njoftuar nga mediat që Këshilli Bashkiak paska bërë një kërkesë drejtuar SPAK dhe Drejtorisë së Burgjeve për të siguruar pjesëmarrjen e Erion Veliqit në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Në dijeninë tonë, një nga anëtarët e mazhorancës i ka bërë njoftim këshillit, por që Këshilli vetë të mbledhet, të diskutojë, kryesia sidomos, kjo është diçka që nuk ekziston, duan ta shesin në media sikur është kërkesë e Këshillit Bashkiak, si e të gjithë këshilltarëve, e jo thjesht e një grupi të këshilltarëve të mazhorancës.

Kjo është zgjedhja e këshilltarëve të majtë, të cilët në vend që të kërkojnë që të shkojnë dhe të konsultohen me qytetarët për Reformën Territoriale, duan të na sjellin të pandehurin dhe të burgosurin Erion Veliq në mbledhje këshilli, po për çfarë na duhet ai?

Ata e kanë kërkuar dhe dy herë të tjera, por të mbash një vit e gjysmë peng Tiranën, në një papërgjegjshmëri totale dhe që ne ende nuk e dimë de-facto se kush e drejton Bashkinë e Tiranës, me një kryetar bashkie i cili është zyrtarisht në detyrë por është në paraburgim në Durrës, ndërkohë që Tirana, ky kryeqytet nuk qeveriset fare.

Nga një anë nuk ka qeverisje dhe nga ana tjetër shtohet edhe kjo paaftësi dhe mungesë totale e ndërgjegjes humane që e mban peng prej 20 muajsh Tiranën, se i duhet Erion Veliq, që kur të shkojë në Gjakatën e Strasburgut, të ketë edhe në kuriz edhe karrigen e kryetarit të bashkisë, për t'i dhënë disa pikë më tepër, për hijçgjë', u shpreh Teliti.

Nënkryetari i Këshillit ironizoi tentativat e mazhorancës për të sjellë Veliqin nga

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s'menaxhon dot më

Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë

Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin

Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës

paraburgimi i Durrësit, duke thënë se mbledhjet e institucionit nuk mund të përdoren si mundësi që i pandehuri të dalë për të marrë ajër.

Teliti u shpreh se në vend që këshilltarët e majtë t'i bëjnë shërbime dhe t'i sigurojnë leje daljeje Veliajt, duhet të bashkoheshin me kërkesën e opozitës për të detyruar kryebashkiakun të japë dorëheqjen e menjëhershme.

'Kjo mungesë totale e Veliajt dhe e papërgjegjshmërisë së ekipit të tij, po e zhyt Tiranën në kaos total e cila në fund fare përkethehet në rënie dhe përkeqësim të mirëqenies tonë.

Në vend që këshilltarët të kërkojnë dorëheqjen e tij, kërkojnë të na sjellin në mbledhje të marrë dy orë liri nga Durrësi, pse mbledhja e Këshillit Bashkiak është të marrë ajër Veliajt.

Në vend se të detyrojmë atë drejt dorëheqjes, se po e mban peng karrigen e kryetarit, për interesa të veta', tha Teliti.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Arrestimi i Vlorë Hyseni/ Gjunksi: Jo vetëm çështje faji, duhen parë përgjegjësit për emërimin



SYRI TV/ Pikëpyetje për shpenzimet në Portin e Durrësit, 178 mijë euro për panele, 88 mijë euro humbje



Monologu ...i atyre që i ikin!

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



Rama zhgënjën mediat në Prishtinë: Kosova pa zë në OKB, asnjë fjalë për UÇK-në



Mbyllet protesta e 118/ Qytetarët të vendosur deri në largimin e Ramës: Nesër më shumë!



'Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty'/ Kush mban përgjegjësi për skandalin e SHISH?



Konjufca në New York: Aktgjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së është padrejtësi që duhet të korrigjohet



VIDEO/ Mban titullin 'doktor shkencash', Taulant Balla e ka kopjuar dizertacionin nga një punim shkencor evropian



Mbyllen fjalimet/ Shiu s'i pengon qytetarët të marshojnë nëpër Tiranë: Rama, jepe dorëheqjen!



'Fjalim lamtumire në OKB?'/ Harxhi: Nga podiumi global, Shqipëria nuk mund të fshihet pas propagandës

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net